



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Datë: 08.04.2022

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 68 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 17, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, Vendimin e Kuvendit të Komunës Nr. 59 të datës 07.03.2022, bën këtë:

NJOFTIM PËR PJESËMARRJE NË DISKUTIM PUBLIK

Njoftohen qytetarët e Komunës së Fushë-Kosovës dhe të gjithë të interesuarit e tjerë, se diskutimi publik është i hapur nga data 08.04.2022-21.04.2022 për: **“Programin Trevjeçarë të Banimit në Komunën e Fushë-Kosovës”**.

Për sqarime dhe konsultime lidhur me Programin Trevjeçarë të Banimit, mund të drejtoheni në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, kati i parë, në ndërtesën e Komunës së Fushë-Kosovës.

Takimi për konsultim publik do të mbahet më datën: **19.04.2022, në orën 10:00h**, në sallën e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, në ndërtesën e Komunës. Njoftimi për diskutim publik vendoset në tabelën e shpalljeve në ndërtesën e komunës dhe publikohet në ueb-faqen e komunës së Fushë-Kosovës.

Përshëndetje!

**Kryetari i Komunës
Burim Berisha**

